



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SHPRESA GJOCI**  
**ADRESA NJESIA AMDINISTRATIVE**  
**NR. 5,**  
**TEL: 0682071706**

# **KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME**

**(KUOTA KAPITALI)**

**Nr. repertori: 1203**

**Nr. koleksioni: 810**

**Tirane më 09/02/2022**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022053920086239082



A2022053920086239082

## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( TË SHOQËRISË "Team Blink" SH.P.K)



Sot, më datë 09.01.2022, para meje Notere SHPRESA GJOCI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA AMDINISTRATIVE NR. 5, , u paraqit personalisht:

### SHITES:

Shoqëria DIVINUS INVESTMENTS, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L81707021H, me adresë Rruga Papa Gjon Pali li, Arena Center, Hyrja Ab, Kati +2, Zyra A2/+2, përfaqësuar nga Administratori dhe ortaku i vetëm Florid Ismailaj, atësia Idajet, amësia Floresha, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Mustafa Xhabrahimi 03910088; Nd. 4; H. 1; Farkë; Sauk; 1044; Tiranë, lindur më 04/03/1996, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033045093 dhe nr. personal J60304043E.

### BLERES:

Holger Cara, atësia Artur, amësia Tefta, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga A.Moisiu; Nd. 074; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Tiranë 4; 0000; Tiranë, lindur më 18/05/1996, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031986998 dhe nr. personal J60518035U, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Team Blink" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

### NENI 1

#### PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Une zoti.Florid Ismailaj,perfaqesues i shoqerise "DIVINUS INVESTMENTS" duke mbajtur pergjegjesi te plote ligjore deklaroi se:

Shoqeria DIVINUS INVESTMENTS eshte ortake e vetme ne shoqerine "Team Blink" Shpk me seli ne Tirane, me NUIS M12423002A, me pjesemarrje ne perqindje 100%, me numer pjese 1( nje), fakt qe e vertetoj me ekstraktin e regjistrimit tregtar te leshuar nga QKB, qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

Me marreveshje me Z.Holger Cara, kemi rene dakord qe shoqeria ti shes ketij te fundit 10 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "Team Blink" Shpk.

Une pala blerese zoti.Holger Cara, deklaroi se sa u tha me lart jam dakord dhe nuk kam asnje pretendim ligjor.



A2022053920086239082

## NENI 2

### ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1 Çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare 10 000 ( dhjetemije) Leke.

2.2 Palët deklarojnë se nga ana e Blerësit likujdimi i kesaj vlere monetare të sipërcituar, është bere kesh jashte zyres noteriale.

**Me kete veprim te bere ne mes tyre, behet pronar ne kuotat e kapitalit te shoqerise "Team Blink" Shpk zoti.Holger Cara ne masen 10 %.**

## NENI 3

### BAZA LIGJORE

3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

## NENI 9

### ANEKSET E KONTRATËS

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 3, datë 01.02.2022
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "Team Blink" Sh.p.k. dhe Divinus Invements
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

## NENI 13

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.



A2022053920086239082

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### PALËT KONTRAKTUESE

#### BLERES

Holger Cara

Holger Cara 


#### SHITES

Shoqëria DIVINUS INVESTMENTS,

Florid Ismailaj

FLORID ISMAILAJ

  
Noter  
SHPRESA GJOCI

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M12423002A
2. Data e Regjistrimit	23/12/2021
3. Emri i Subjektit	TEAM BLINK
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	20/12/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/12/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Papa Gjon Pali II, Arena Center, Hyrja AB, Kati i 2, Zyra A2/+2, Tiranë, Shqipëri.
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Krijimi,zoterimi,menaxhimi,mbajtja e te drejtave i ekipeve te sportit elektronik ku, shoqeria ka per objekt dhe qellim te saj ushtrimin e aktiviteteve te ndryshem,turneve ne fushen e sportit elektronik (ESPORTS) ne arena kombetare dhe nderkombetare ,te organizuara nga federata kombetare apo nderkombetare te sportit elektronik ,institucione publike/shteterore shqiptare,apo te huaja. Shoqeria ka per objekt shitje,blerje,prodhim,tregti me shumice dhe pakice i artikujve sportive , veshjeve ,aksesoreve,si dhe te cdo artikulli industrial. Aktivitete reklamimi,ekspozim i brandit ,marketing ,ushtrim te aktiviteteve te agjensive publicitare te komunikimeve , medias së shkruar apo radiotelevizive, social media ,portale online si dhe dhenia e sherbimeve te lidhura me to.Ngritja e shkollave akademike te sportit elektronik ,menaxhim lojtaresh te rinj dhe te vjeter sipas kontratave perkatese. Mbajtja e te drejtave te kartonit te lojtareve sipas kontratave perkatese. Aplikimi,konkurrimi,perfitimi per grante,donacione,financime,sponsorizime,nga burime buxhetore me karakter kombetare apo nderkombetare. Dhenia e sherbimeve te mesiperme per llogari te paleve te treta,perfshire ketu sherbime te organizimit administrativ,sportiv dhe tregtar,marrja persiper dhe menaxhimi i te drejtave kontraktore te cfaredolloji per llogari te te treteve,konsulence dhe sherbime admnistrimi ,

Kopje

	financiare, strategjike ,analitike ,teknike te sportit Elektronik brenda ose jashte vendit.Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar , Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt ,qe eshte rezultat ose lidhjet me objektivin e mesiperm.	
10. Administratori/ët	Holger Cara	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 20/12/2021	Deri: 20/12/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	DIVINUS INVESTMENTS	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: TEAM BLINK E-Mail: teamblink@blink.al Telefon: 0696007540	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 08/02/2022

\_\_\_\_\_  
 Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
 (i nëpunësit të sportelit)

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81707021H
2. Data e Regjistrimit	07/05/2018
3. Emri i Subjektit	DIVINUS INVESTMENTS
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	04/05/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/05/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Papa Gjon Pali II, Arena Center, Hyrja AB, Kati +2, zyra A2/+2
8. Kapitali	1.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Shoqëria e cila ka organizimin si një shoqëri holding, do të jetë zotëuese e kuotave të një ose disa shoqërive të tjera dhe do të ofrojë asistencë për shoqëritë e zotëruara në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të terthortë nga vetë Shoqëria apo ortakët e saj (në vijim shoqëritë e grupit), ka për objekt dhe qëllim të saj ushtrimin e aktiviteteve, që do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në sa më poshtë: Zoterimi dhe administrimi i kuotave të shoqërive të kontrolluara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kordinimi teknik, administrativ, financiar dhe organizativ të shoqërive të grupit. Dhenie e garancive të të gjitha llojeve në favor të shoqërive të grupit dhe dhenia shërbimeve të analizës, koordinimit, studimeve të tregut, marketingut, etj. Orientim në vendosjen e objektivave dhe strategjive, koordinimin e aktiviteteve të shoqërive të grupit, të vendosje objektivat financiare, të kontrollojë sjelljen dhe efektivitetin financiar, dhe të përgjithësi, menaxhimin dhe kontrollin financiar si dhe mbështetjen në këtë drejtim të shoqërive të grupit. Keshillim i vazhdueshëm për aktivitetet tregtare të shoqërive të grupit, që do të përfshijë por nuk do të kufizohet në studime dhe asistencë për themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve tregtare në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin mbi shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë, asistencë në hartimin e statuteve, mbajtjen e librave të shoqërive tregtare dhe përbushjen e detyrimeve pranë organeve përkatëse,

	<p>asistence ne pergatitjen e planeve te biznesit, asistence ne pergatitjen dhe zbatimin e programeve te ristrukturimit dhe uljes se kostove, asistence ne planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ekonomike te jashtezakonshme te shoqerive (ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje sipermarrjesh ose degesh te tyre; transformime, mbyllje dhe likuidim te shoqerive). Keshillim financiar duke perfshire por pa u kufizuar ne analizen financiare per strategjite e zhvillimit, pergatitjen e planeve te financimit, keshillim dhe asistence ne operacionet e kredise, studim dhe kerkim burimesh financiare me kushte lehtesuese, asistence ne operacionet e investimeve te paluajtshme, dhe fusha te tjera qe lidhen me aktivitetin e shoqerive te grupit. Asistence ne kerkimin, punesimin e personelit, dhe vendosja ne dispozicion te shoqerive te grupit te personelit te kualifikuar sipas nevojave. Studime dhe keshillim ne fushen e inxhinierise, se projekttimeve civile e industriale dhe analizave te tregu si dhe keshillim ne çdo sektor dhe fushe qe lidhet dhe mbështet ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte ose indirekte veprimtarine ekonomike te shoqerive te grupit. Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji pre realizimin e objektit te aktivitetit te saj. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike eolike, fotovoltaike, hidrike dhe gjeotermale e marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.</p>	
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit	Florid Ismailaj Nga: 04/05/2018      Deri: 04/05/2023	
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit 12.2 Numri i pjesëve 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)  - Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	Florid Ismailaj Para: 1.000.000,00      Natyre: 1,00 100,00	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		



14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: DIVINUS INVESTMENTS E-Mail: esports.blink@gmail.com Telefon: 0684017270
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 08/02/2022

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga WOS

---

**REZULTATET E KËRKIMIT**

---

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-20220208164857558
Data e Rezultatit te Kerkimit:	08.02.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	4:48:57PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-271-68765
Referenca e Perdoriesit:	

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

TEAM BLINK SH.P.K.  
DIVINUS INVESTMENTS SH.P.K.



*Indira Beky*

